



KRYQI I KUQ SHQIPTAR

KODI I SJELLJES

(Miratuar për herë të parë në Asamblenë VI të Përgjithshme, 2002)

Hyrje

Kryqi i Kuq Shqiptar është një shoqatë kombëtare humanitare që përmbush misionin dhe objektivat e veta, duke vepruar gjithnjë në përputhje me Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

Anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit e shoqatës janë në çdo rrethanë, zëri dhe mbrojtësit e njerëzve më në nevojë. Ata veprojnë sipas kërkesave të këtij Kodi të Sjelljes dhe në përputhje me Parimet Themelore.

Përpara se të kryejnë një veprim, anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit e shoqatës duhet t'i bëjnë vetes këto pyetje:

- *A është ky veprim në përputhje me Parimet Themelore?*
- *A pajtohet ky veprim me këtë Kod të Sjelljes, Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Kryqit të Kuq Shqiptar?*
- *A pajtohet ky veprim me të gjitha politikat, procedurat dhe udhëzimet e ndryshme të shoqatës?*
- *A është ligjor ky veprim sipas legjislacionit brenda dhe jashtë vendit?*
- *A do të ketë pasojë negative ky veprim mbi mua dhe shoqatën?*

Kur anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit e shoqatës dyshojnë nëse një veprim përputhet ose jo me këtë Kod të Sjelljes apo pasojat etike të tij, duhet të këshillohen, me eprorin e tyre të linjës përpara se të veprojnë.

Qëllimi dhe fusha e veprimit

Ky Kod i Sjelljes është i detyrueshëm për t'u aplikuar nga të gjithë anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit, në çdo kohë, si gjatë angazhimit në veprimtarinë e shoqatës, ashtu edhe jashtë saj.

Kodi i Sjelljes, pavarësisht nëse nënshkruhet ose jo, duhet automatikisht të jetë pjesë e të gjitha kontratave të punësimit dhe kushteve të shërbimit për të gjithë anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit.

Shkeljet e Kodit janë subjekt i masave disiplinore të bazuara në Rregulloret e shoqatës, sipas rastit.

Detyrimet që lidhen me Ruajtjen e Informacionit, pikat 21-25 të rregullave të sjelljes si më poshtë, qëndrojnë në fuqi edhe pas largimit nga detyra në Kryqin e Kuq Shqiptar.

Kryqi i Kuq Shqiptar është i përkushtuar për të siguruar që të gjitha institucionet, bizneset, organizatat dhe individët me të cilët punon, ndajnë vlera të ngjashme me ato të shoqatës, në

veçanti individët me të cilët shoqata ka një lidhje të ngushtë, por jo të drejtpërdrejtë, si për shembull punonjës apo organizata partnere që veprojnë në bashkëpunim të ngushtë me shoqatën, roje që punojnë për kompani sigurie, punëtorë të një kompanie ndërtimi të kontraktuar nga shoqata, etj. Kryqi i Kuq Shqiptar do të marrë masat e duhura për të ndërprerë bashkëpunimin me çdo organizatë apo individ, veprimet e të cilit mund të konsiderohen si shkelje të rënda të këtij Kodi nëse evidentohen nga shoqata.

Zbatimi i Kodit të Sjelljes

Përgjegjësitë e punonjësve:

Punonjësit janë përgjegjës për t'u siguruar që e kanë lexuar dhe kuptuar Kodin e Sjelljes. Ata gjithashtu kanë për detyrë të informojnë përfituesit e shërbimeve të tyre dhe punonjësit nën varësi, për respektimin e Kodit të Sjelljes, si dhe procedurat e raportimit (si dhe kujt duhet t'i raportojnë) të shkeljeve, sjelljeve të pahijshme apo gabimi në standardin e trajtimit të tyre.

Punonjësit kanë për detyrë që të raportojnë çdo shkelje të këtij Kodi pranë personit të duhur. Të gjitha raportimet dhe shqetësimet e ngritura duhet të shqyrtohen me maturi dhe në mënyrë diskrete. Shoqata do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm kundër çdo forme hakmarrjeje të shkaktuar prej raportimeve të shkeljeve të mundshme të këtij Kodi.

Përgjegjësitë e drejtuesve:

Drejtuesit duhet të udhëheqin nëpërmjet shembullit të tyre dhe janë përgjegjës për krijimin e një mjedisi pozitiv të respektimit të Kodit të Sjelljes. Ata duhet të informojnë *përgjegjës* për burimet njerëzore mbi të gjitha raportimet apo shqetësimet e raportuara në shkelje të këtij Kodi.

Marrëdhëniet mes drejtuesve dhe anëtarëve, vullnetarëve, të zgjedhurve dhe punonjësve duhet të udhëhiqen nga respekti dhe mirëkuptimi reciprok. Drejtuesit duhet të jenë të gatshëm për të dëgjuar në mirëbesim çdo individ që ngre një shqetësim dhe duhet t'i shqyrtojnë këto kërkesa në mënyrë të ndjeshme dhe të paanshme.

Drejtuesit janë përgjegjës për tërheqjen e vëmendjes së institucioneve dhe individëve me të cilët shoqata bashkëpunon për sjellje që i konsideron të papërshtatshme apo që nuk pajtohen me vlerat e Kryqit të Kuq Shqiptar. Në rast se këto veprime konsiderohen shkelje të rënda të Kodit të Sjelljes, drejtuesit janë përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve të duhura, duke përfshirë edhe masa për zëvendësimin e individëve të caktuar, deri në prishjen e kontratës. Në çdo rast drejtuesit janë të ftuar të këshillohen më përfaqësuesit ligjorë.

Përgjegjësia institucionale:

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për vendosjen e mekanizmave efektivë për t'u siguruar që standardet më të larta të sjelljes, të aplikohen si në drejtim të shërbimit ndaj njerëzve më në nevojë, ashtu edhe në marrëdhëniet profesionale të brendshme dhe të jashtme të shoqatës.

Rregullat e Kodit të Sjelljes

Baza ligjore e Kryqit të Kuq Shqiptar dhe ligjet e vendit

Anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit kanë për detyrë të:

1. Respektojnë Statutin, Rregulloren e Brendshme, Rregulloren e Funkcionimit Administrativ dhe rregulloret e tjera, politikat dhe kushtet e kontratës së punës apo shërbimit.
2. Respektojnë ligjet e shtetit, përfshirë Ligjin për Kryqin e Kuq Shqiptar, Ligjin për Emblemën e Kryqit të Kuq Shqiptar apo marrëveshje të shoqatës. Në rast shkeljeje të këtyre ligjeve, shoqata nuk mban përgjegjësi dhe nuk ofron asistencë ligjore për individin.

Respekti për njerëzit

Anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit duhet të:

3. Respektojnë të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë ndasi apo diskriminim për shkak të kombësisë, racës, gjinisë, besimit fetar, nivelit shoqëror apo opinionit politik. Ata veprojnë në çdo kohë në përputhje me Parimet Themelore dhe vlerat humanitare të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.
Me vlera humanitare të Lëvizjes Ndërkombëtare kuptojmë:
 - respektin për diversitetin, për kulturat, për strukturat dhe zakonet e komuniteteve të ndryshme,
 - solidaritetin me njerëzit në nevojë,
 - integritetin dhe llogaridhënien,
 - si edhe mirëkuptimin e dyanshëm dhe mos diskriminimin si elementë thelbësorë për ruajtjen e dinjitetit njerëzor.
4. Marrin në konsideratë ndjeshmërinë e njerëzve ndaj traditave, zakoneve dhe besimeve fetare dhe shmangin çdo sjellje të pavend në një kontekst të caktuar kulturor.
5. Sigurohen që janë bërë përpjekjet e duhura për t'u shpjeguar përfituesve se si do të përdoren fotografitë apo historitë dhe të merret leje prej tyre për përdorimin e këtyre materialeve, duke e dhënë imazhin e individëve dhe të rrethanave të tyre, në mënyrë të drejtë me kapacitetet dhe nevojat e tyre.
6. Shmangen nga çdo veprim që mund të konsiderohet ngacmim, abuzim, diskriminim apo shfrytëzim. Kjo vlen për të gjithë njerëzit e të gjitha moshave, veçanërisht për fëmijët dhe për njerëzit e ekspozuar ndaj diskreditimit, përfshirë ata që jetojnë me HIV.

Pavarësia

Anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit duhet të:

7. Veprojnë vetëm duke pasur parasysh interesat e shoqatës.
8. Mos kërkojnë apo mos pranojnë udhëzime nga qeveria apo ndonjë autoritet tjetër jashtë shoqatës.

9. Respektojnë emblemen e Kryqit të Kuq Shqiptar dhe të komponentëve të tjerë të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, duke i përdorur ato vetëm për qëllimet e përcaktuara dhe duke raportuar çdo keqpërdorim të tyre.

Integriteti

Anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit duhet të:

10. Kryejnë detyrat zyrtare me integritet, larg nga çdo formë pandershmërie ose korrupsioni, përfshirë mos pjesëmarrjen në asnjë procedurë favorizuese, nepotizmi, miqësie ose ryshfeti. Këtu përfshihet mos pranimi pa autorizim i asnjë dhurate, titulli, dekorate, shpërblimi, favorizimi ose të mira ekonomike më shumë sesa një "dhuratë simbolike" nga burime të jashtme (përfshirë Shoqatat Kombëtare, qeveritë, korporatat apo të tjerë). Shembull i një dhurate simbolike është një stilolaps i lirë, një bllok shënimesh, një spinë e thjeshtë, etj.
11. Mos përfitojnë vetë apo të mos lejojnë një palë të tretë të përfitojë në mënyrë të papërshtatshme (në mënyrë direkte ose indirekte) nga bashkëpunimi me një kompani që ka marrëdhënie biznesi apo transaksioni me Kryqin e Kuq Shqiptar (përfshirë kompanitë që bashkëpunojnë në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e interesave financiare). Çdo konflikt interesi me një furnizues, ofrues shërbimi ose partner biznesi (kur ka marrëdhënie familjare ose ndarje fitimi) duhet evidentuar dhe raportuar.
12. Të mos përdorin qëllimisht funksionin e tyre zyrtar apo titullin e tyre pranë asnjë entiteti apo personi.
13. Të mos bëjnë asnjë veprim që mund të çojë në prishjen e imazhit të Kryqit të Kuq Shqiptar.

Neutraliteti

Anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit duhet të:

14. Mos shprehin publikisht asnjë opinion për aktivitete që lidhen me çështje politike. Ata nuk duhet të përfshihen në asnjë aktivitet politik që cenon paanësinë, neutralitetin ose pavarësinë e Kryqit të Kuq Shqiptar, p.sh. mbështetje publike të një partie politike.
15. Të mos pranojnë të marrin pjesë në aktivitete apo të ushtrojnë detyra publike, të cilat bien ndesh me paanësinë, neutralitetin ose pavarësinë, ose që përbëjnë konflikt interesi.
16. Respektojnë një kod veshjeje të përshtatshëm me detyrën e tyre në mënyrë që të shmanget çdo lloj ngjashmërie me uniformat ushtarake.

Abuzimi dhe shfrytëzimi seksual

Anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit duhet të:

17. Të mos kryejnë asnjë akt të shfrytëzimit, abuzimit apo dhunës seksuale. Ky rregull vlen për të gjitha format e abuzimit ose shfrytëzimit seksual dhe përfshin edhe mos

raportimin e shqetësimeve ose dyshimeve në lidhje me ndonjë shkelje nga një bashkëpunëtor (qoftë koleg apo një individ që punon për një institucion partner).

18. Të mos përfshihen në asnjë formë aktiviteti seksual me përfituesit (të rritur ose fëmijë që kërkojnë ose përfitojnë nga mbrojtja dhe ndihma e shoqatës). Të mos përfshihen në asnjë formë raporti seksual me personat nën 18 vjeç (hamendësimi i gabuar për moshën e fëmijës, nuk është justifikim). Aktiviteti seksual" përfshin të gjitha format abuzimit me natyrë seksuale, me apo pa kontakt fizik dhe pavarësisht nëse njëra palë është ose nuk është e vetëdijshme për një abuzim të tillë.
19. Të mos shkëmbejnë para, punësim, mallra apo shërbime për marrëdhënie seksuale, përfshirë favorizimet seksuale apo forma të tjera të poshtërimit, degradimit ose shfrytëzimit.
20. Të mos prodhojnë, blejnë, shpërndajnë apo përdorin asnjë material pornografik në zyrat e Kryqit të Kuq Shqiptar ose në pajisjet e Kryqit të Kuq Shqiptar, përfshirë hulumtimin e faqeve pornografike në internet, bisedave me përmbajtje pornografike ose dërgimin me postë elektronike, të materialeve pornografike.

Ruajtja e informacionit

Vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit duhet të:

21. Trajtojnë me kujdes maksimal informacionet konfidenciale apo të ndjeshme.
22. Mos përdorin informacione të ndjeshme të përfituesve kur ka rrezik për pasoja negative mbi individët nëse bëhet publik identiteti i tyre. Duhet të gjitha përpjekjet për ruajtjen e identitetit të përfituesve, përfshirë emrin e tyre, fytyrën dhe pozicionin gjeografik. Publikimi mund të bëhet vetëm në rastet kur heshtja e vë në rrezik individin, përfituesin apo punonjësin, gjithmonë duke i njoftuar paraprakisht dhe duke iu mbrojtur sa më shumë të jetë e mundur identiteti.
23. Mbrojnë konfidencialitetin e informacionit të brendshëm të Kryqit të Kuq Shqiptar dhe nuk i komunikojnë korrespondencat e brendshme ose informacionet që ata i njohin për shkak të pozicionit zyrtar, por nuk janë bërë publike, jashtë institucionit. Ata nuk duhet në asnjë rast të përdorin informacione të brendshme të Kryqit të Kuq Shqiptar për përfitime personale.
24. Të informojnë menjëherë organet drejtuese në rast se thirren nga institucionet ligj zbatuese për të dhënë prova apo informacione që ata i njohin për shkak të detyrës zyrtare.
25. Të mos publikojnë asnjë material (shkrim, fotografi, video, etj) që është prodhuar për arsye pune apo që ka lidhje me punën, detyrën dhe funksionin e tyre në shërbim të Kryqit të Kuq Shqiptar, pa aprovimin paraprak të shoqatës. Të drejtat e pronësisë intelektuale për çdo punë që kryhet për Kryqin e Kuq Shqiptar, i takojnë shoqatës. Vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit i transferojnë shoqatës të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale, si dhe çdo të ardhur që rrjedh nga ky publikim.

Siguria

Anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit duhet të:

26. Ndjekin kërkesat e udhëzimeve apo procedurave në lidhje me sigurinë që shoqata ka në fuqi, sipas rrethanave.
27. Binden ndaj rregullave të drejtimit të automjeteve të vendit kur drejtojnë makinat e Kryqit të Kuq Shqiptar. Në veçanti, e kanë rreptësisht të ndaluar të drejtojnë makinat e Kryqit të Kuq Shqiptar nën ndikimin e alkoolit ose substancave narkotike.
28. Nuk duhet të shkelin ligjin dhe rregullat e qarkullimit rrugor kur drejtojnë makinat e shoqatës apo ato personale. Ata që përballen me akuza kriminale ose penale për drejtim të mjeteve në gjendje të dehur, nuk duhet të pretendojnë asnjë ndihmë ligjore nga Kryqi i Kuq Shqiptar.
29. Në asnjë rast nuk duhet të përdorin ose mbajnë, asnjë lloj droge.
30. Të sigurohen që asnjë lloj arme zjarri apo municione, të çfarëdo lloji, të futen apo mbahen në automjetet, zyrat apo pronat e Kryqit të Kuq Shqiptar.

Pronat e Kryqit të Kuq Shqiptar

Anëtarët, vullnetarët, të zgjedhurit dhe punonjësit duhet të:

31. Administrojnë fondet dhe materialet që u janë besuar me kujdesin më të madh dhe të jenë të përgjegjshëm në përdorimin e tyre. Ndalohet vjedhja, shpërdorimi ose keqpërdorimi i fondeve dhe i pronave të Kryqit të Kuq Shqiptar.
32. Në fund të punësimit apo shërbimit të tyre ndaj shoqatës, të kthejnë të gjitha aktivet që u janë dhënë në përdorim nga Kryqi i Kuq Shqiptar, përfshirë kartat identifikuese.

DEKLARATË PRANIMI

Unë _____, konfirmoj se e kam lexuar dhe kuptuar *Kodin e Sjelljes në Kryqin e Kuq Shqiptar* dhe jam dakord me rregullat e përcaktuara në të, çka përfshihet në kushtet e punësimit / angazhimit tim në Kryqin e Kuq Shqiptar.

Nënshkrimi _____

Vendi _____

Data _____